

PRANUAR MË:

ACCEPTED ON:

PRIMLJENO:

05.06.2024

02/247

REPUBLIKA E KOSOVËS
KUVENDI I KOMUNËS NË MALISHEVË

Kuvendi i Komunës

Nr. 02/

Datë: 04.06.2024

Në bazë të nenit 4, nenit 8, nenit 11, nenit 12 paragrafi 2 shkronja (d), nenin 14, nenit 16, nenin 17 paragrafi 1 shkronja (c), nenit 40, të Ligjit Nr.03/L-040 për Vetëqeverisje Lokale "Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës nr.28/2008", në mbështetje të nenit 24 paragrafi 1 dhe 2 dhe nenit 25 paragrafi 2 dhe 3 dhe nën paragrafi 3.2, paragrafi 5, të Ligjit Nr.06/L-092 për dhënien në shfrytëzim dhe këmbimin e pronës së paluajtshme të Komunës, "Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës nr.10/03, Prill 2019", nenit 29,30 par.2 të Rregullores (QRK) nr.09/2020 për përcaktimin e procedurave të dhënies në shfrytëzim dhe këmbimin e pronës së paluajtshme të komunës, neni 29 par. 29.4 dhe 29.5 dhe 6 dhe neni 31 par 1 dhe neni 31 par.31.1 pika 5, Statutit të Komunës së Malishevës, Kuvendi i Komunës së Malishevës në mbledhjen e mbajtur me datë: 30.05.2024:

V E N D I M

PËR SHPALLJNE ME INTERES TË PËRGJITHSËM PUBLIK TË PRONËS PRIVATE DHE KËMBIMIN E TË NJËJTËS ME PRONË PUBLIKE

1. Shpallet zonë me interes të përgjithshëm publik, sipërfaqja prej 2300 m² në pjesën e njësive kadastrale nr.P-72310047-00982-116, në vendin e quajtur " Gërmiza te shkolla " parcelë -tokë ndërtimore me destinim oborr, pjesë e pronës 1/1, në pronësi të **Hazir Dul Tredhaku** nga Malisheva, e cila gjendet në zonën kadastrale në Malishevë, Komuna e Malishevës.

dhe,

1.1.Sipërfaqja prej 241 m², në pjesën e njësive kadastrale nr.P-72310047-01430-4, në vendin e quajtur "Gropa Kregza " parcelë infrastrukturë, shfrytëzimi aktual rrugë, pjesë e pronës 1/1, në emër të **Hazir Dul Tredhaku nga Malisheva**, e cila gjendet në zonën kadastrale në Malishevë.

1.2 Ky vendim me të cilin shpallet zonë me interes të përgjithshëm publik, në pjesët e njësive kadastrale të cekur sipas nenit 1 dhe neni 1 paragrafi 1.1, është marrë në pajtim me, kërkesën nr.02/207, e datës 20.05.2024, e parashtruar nga z.Hazir Tredhaku nga Malisheva, për këmbimin e pronës private e cila gjendet në pjesën e njësive kadastrale nr.P-72310047-00982-116, në vendin e quajtur " Gërmiza te shkolla " parcelë -tokë ndërtimore me destinim oborr , pjesë e pronës 1/1, dhe pjesën e njësive kadastrale nr.P-72310047-01430-4, në vendin e quajtur "Gropa Kregza " parcelë infrastrukturë, shfrytëzimi aktual rrugë, pjesë e pronës 1/1, në emër të **Hazir Dul Tredhaku nga Malisheva**, në sipërfaqe të përgjithshme prej 2541 m² e cila gjendet në zonën kadastrale në Malishevë, në pronësi të **Hazir Dul Tredhaku** nga Malisheva, dhe propozimit të kryetarit të komunës nr.01/639, dt.29.05.2023, të listës së pronave publike, të cilat do të hynë në proces të

vlerësimet dhe këmbimit sipas ligjit, në lidhje me kërkesën nr.02/207, dt.20.05.2024, të parashtruar nga pala, pronat private të cilit, i nënshtrohen këtij vendimi, për shpalljen zonë me interes të përgjithshëm publik, për komunën e Malishevës.

2. Prona e paluajtshme komunale, e propozuar dhe miratuar për këmbim gjendet në zonën kadastrale në Malishevë, Komuna e Malishevës, me këto karakteristika;

- 2.1 Njësia kadastrale me numër, P-72310025-00223-652, në vendin e quajtur "*Palanka -Golesh*", pjesë e pronës 1/1, në sipërfaqe prej 1880 m² në pronësi publike, në emër të KK-Malishevës.
- 2.2 Njësia kadastrale me numër, P-72310025-00223-681, në vendin e quajtur "*Palanka Golesh*" pjesë e pronës 1/1, në sipërfaqe prej 4452 m², në pronësi publike, të KK-Malishevës.
- 2.3 Njësia kadastrale me numër, P- 72310025-00223-650, në vendin e quajtur "*Palanka Golesh*" pjesë e pronës 1/1, në sipërfaqe prej 3335 m², në pronësi publike të KK-Malishevës.
- 2.4 Njësia kadastrale me numër, P-72310025-00223-648, në vendin e quajtur "*Palanka -Golesh*" pjesë e pronës 1/1, në sipërfaqe prej 3885 m², në pronësi publike të KK-Malishevës.
- 2.5 Njësia kadastrale me numër P-72310025-00223-647, në vendin e quajtur "*Palanka -Golesh*" pjesë e pronës 1/1, në sipërfaqe prej 2954 m² në pronësi publike të KK-Malishevës.
- 2.6 Njësia kadastrale me numër.P-72310025-00223-712, në vendin e quajtur "*Palanka -Golesh*" pjesë e pronës 1/1, në sipërfaqe prej 450 m² në pronësi publike në emër të KK-Malishevës.
- 2.7 Njësia kadastrale me numër, P-72310047-01004-997, në vendin e quajtur "*Golesh -Golesh*" pjesë e pronës 1/1, në sipërfaqe prej 6161 m², në pronësi publike në emër të KK-Malishevës.
- 2.8 Njësia kadastrale me numër,P-72310047-00884-0, në vendin e quajtur "*Fusha -Res*" pjesë e pronës 1/1, në sipërfaqe prej 1558 m², në pronësi publike në emër të KK-Malishevës.
- 2.9 Njësia kadastrale me numër P-72310047-00982-114, në vendin e quajtur "*Gërmiza te Shkolla*" pjesë e pronës 1/1, në sipërfaqe prej 667 m², në pronësi publike në emër të KK-Malishevës.
- 2.10 Njësia kadastrale me numër, P-72310025-00223-695, në vendin e quajtur "*Palanka -Golesh*" në sipërfaqe prej 450 m², në pronësi publike në emër të KK-Malishevës.
- 2.11 Njësia kadastrale me numër P-72310025-00223-694, në vendin e quajtur "*Palanka -Golesh*" pjesë e pronës 1/1, në sipërfaqe prej 450 m², në pronësi publike në emër të KK-Malishevës.
- 2.12 Njësia kadastrale me numër, P-72310025-00223-693, në vendin e quajtur "*Palanka -Golesh*" pjesë e pronës 1/1. Në sipërfaqe prej 450 m², në emër të KK-Malishevës.

3. Këmbimi do të bëhet vetëm pasi të përmbushën kushtet e parapara konform nenit 25 të Ligjit nr.06/L-092, për Dhënien në Shfrytëzim dhe Këmbimin e Pronës së Paluajtshme të Komunës dhe neni 29 dhe 30 të Rregullores (QRK) nr.09/2020, për përcaktimin e procedurave të dhënies në shfrytëzim dhe këmbimin e pronës së paluajtshme të komunës.

4. Kërkesa për këmbim është miratuar, në bazë të dispozitës së nenit 25 par.25.2 pika 3.2, të Ligjit nr.06/L-092, prona private përmes këmbimit do të kalojnë në pronësi publike do të shërbej për qëllimin e ligjshëm publik, ngase në pjesët e njësive kadastrale të shpallura zonë me interes të përgjithshëm publik janë të ndërtuara objektet publike, Qendra Kryesore e Mjekësisë Familjare, " Dr-Shpëtim Robaj " oborri me objektet përcjellëse dhe infrastruktura rrugore në Qytetin e Malishevës, të cilat janë në shërbim publik.

5. Para shpalljes publike të vendimit do të bëhet vlerësimi i kualifikuar i vlerës së tregut të pronës së paluajtshme të Komunës dhe vlerësimi i pronave private, nga Departamenti i Vlerësimit të Pronave të Paluajtshme në kuadër të Ministrisë së Financave, Punës dhe Transfereve.
6. Mënyra dhe kushtet e këmbimit të pronës së paluajtshme do të përcaktohen me kontratë, e cila lidhet dhe evidentohet në mes të kryetarit të komunës dhe pronarit të parcelave që do të këmbëhet. Këmbimi i cekur në pikën 1 dhe paragrafin 1.1 dhe nenin 2 të këtij vendimi do të publikohet në ueb-faqen e Komunës dhe tabelën e shpalljeve me të dhënat e pronave të këmbëvera, vlerën e tyre si dhe emrat e pronarit me të cilin do të bëhet këmbimi.
7. Për zbatimin e këtij vendimi do të kujdesën Kryetari i Komunës, përmes drejtorisë për Gjeodezi, Kadastër dhe Drejtorisë për Pronë.
8. Pjesë përbërëse e këtij vendimi janë: skica grafike, kopjet e planit, certifikatat e njësisë kadastrale.
9. Pas miratimit nga ana e Kuvendit të Komunës së Malishevës, ky vendim hyn në fuqi 15 ditë pas dërgimit në autoritetin mbikëqyrës, në kuptim të nenit 81, të Ligjit nr.03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale, "Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës Nr.28/2008", nenit 8, lidhur me nenin 9 të Rregullores (QRK) Nr.10/2019, për Shqyrtimin Administrativ të Akteve të Komunave, e ndryshuar dhe plotësuar me Rregulloren (QRK) Nr.06/2021 dhe pas shpalljes në ueb-faqen e Komunës.

*-U vendos nga Kuvendi i Komunës së Malishevës, në seancën e mbajtur me datë,
30.05.2024.-*

Vendimi ju dërgohet:

1. MAPL-së,
2. Palës,
3. Drejtorive kompetente,
4. Arkivit të Komunës

